



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:056019

Datë: 03.11.2021

Numri i dokumentit: 02352562

C.nr.491/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.D. nga Prishtina lagjja e Spitalit, kompleksi ... Kati ..., banesa nr..., kundër të paditurës Sh.D. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av.Islam Musa nga Ferizaj, në çështjen juridike vërtetim pronësie në bazë të kontributit , në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur më datë 22.09.2021, në prezencën e paditëses dhe përfaqësuesit të paditurës mori, ndërsa me datë 18 tetor 2021 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi kërkesë padia e paditësit E.D. nga Prishtina lagjja e Spitalit, kompleksi ... Kati ..., banesa nr..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet kontrata mbi dhuratën me nr.LRP.nr.16505/19 dhe ref.nr.5648/19 e datës 22.10.2019, si e pa bazuar.

II.OBLIGOHET paditësja që të paditurës t'ia mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore në vlerë të përgjithshme prej 345€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

III.Anulohet aktvendimi C.nr.491/21 i datës 8 korrik 2021 me të cilin është caktuar masa e përkohshme e sigurisë.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 24.03.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës Sh.D., ku si paditës ka qenë I.D., me objekt kontesti për anulimin e kontratës mbi dhuratën dhe vërtetim pronësie, me propozim për masë të përkohshme. Gjykata me datë 25 mars 2021 i ka kthyer padinë në

plotësim paditësit, dhe me datë 01.04.2021 në plotësim e padisë kanë bërë rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe objektiv dhe si paditës është E.D. nga Prishtina, lagjja e Spitalit, kompleksi ... Kati ..., banesa nr..., e cila ka kërkuar që të anulohet kontrata mbi dhuratën me nr.LRP.nr.16505/19 dhe ref.nr.5648/19 e datës 22.10.2019.

Me datë 8 korrik 2021 gjykata ka aprovuar masën e përkohshme dhe i ka ndaluar të paditurës që të ndërmarr çfarëdo veprimi në drejtim që ta tjetërsoj – bart pronësinë në persona të tretë, ta lë në hipotekë paluatshmërinë ... në vendin e quajtur fabrika e vajit me sipërfaqe prej 444 m² ZK. Ferizaj.

Paditësja E.D., në padi dhe në seancat e mbajtura, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke shtuar se kontrata ose kurorëzimi është obligim që e paditura ka pasur ndaj babait të saj që të kujdeset për shkak të moshës që ka pasur, babai i saj nuk ka qenë në gjendje të aftë që të vendosë dhe i njëjti sipas kontratës mbi dhuratën të vërtetuar tek noteri i ka dhuruar të paditurës paluajtshmërinë dhe këtë kontratë e ka lidhur duke e vënë në lajthim dhe duke e shfrytëzuar gjendjen e tij shëndetësore. Sh. është gruaja e babait (njerka) dhe për këtë arsyeje kërkon anulimin e kësaj kontrate pasi këtë pronë e ka blerë paditësi në vitin 2006 për të cilën ka edhe kontratën e shitblerjes, kërkon që të anulohet kontrata për shkak se e njëjta është e kundërligjshme dhe pasuria që është e babait të saj duhet të shqyrtohet edhe njëherë.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar, nga provat është vërtetuar se babai i paditëses I.D. është martuar me të paditurën Sh.D. rreth vitit 2001 dhe kanë jetuar në bashkësi martesore dhe I. ka qenë pronar i dy shtëpive dhe të njëjtat në vitin 2006 i ka shitur dhe nga dëshmia e dy dëshmitareve F.I. (djali i I.D.) dhe dëshmitarit P.D. është vërtetuar se I. të gjithë fëmijëve që ka pasur me gruan e parë dhe atë 3 djem dhe 6 vajza pas shitjes së këtyre shtëpive ju ka ndarë në pjesë të barabarta nga një pjesë të hollave nga prona e shitur. Në vitin 2006 e ka blerë një oborr pranë fabrikës së vajit në Ferizaj me numër kadastral ...0ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 444 m², ku ka ndërtuar shtëpinë e banimit dhe ka jetuar me bashkëshorten Sh.D. dhe dy fëmijët e lindur në bashkësi martesore me Sh. Me datë 22.10.2019 I.D. ka lidhur kontratë mbi dhurimin e paluajtshmerinë e cila kontratë është vërtetuar tek noteri Selatin Shahini me numër LRP.16505/2021 ref.nr.5648/2019 e cila kontratë është nënshkruar nga I.D. dhe Sh.D. si dhuratëmarrëse me ç rast I.D. i ka dhuruar shtëpinë e banimit me sipërfaqe prej 444m². Pretendimet e paditëses se I.D. nuk ka aftësinë vepruese nuk janë të bazuara pasi ka qenë

detyrë e noterit që në rast se vëren se personi i cili nënshkruan kontratën nuk është në gjendje të aftë të ftoj ekspertin mjekësor për të vërtetuar aftësinë vepruese të tij. Gjithashtu shton se në bazë të nenit 546 të LMD-së (kontrata për dhurim revokohet brenda një viti kur dhuratëdhënësi ka mësuar për arsyet e revokimit),\ ndërsa padia para kësaj gjykate për anulimin e kontratës është ushtruar me datë 24.03.2021, ndërsa kontrata është lidhur me datë 22.10.2019, do të thotë që kjo padi është ushtruar jashtë afatit ligjor dhe mbi këtë bazë kjo kërkesë duhet të refuzohet si e pa bazuar dhe jashtë afatit ligjor, gjithashtu edhe paditëses i mungon legjitimiteti aktiv pasi që anulimin e kontratës së dhuratës mund ta kërkojë vetëm dhuratë dhënësi ashtu siq është paraparë edhe në dispozitat e LMD-së, i propozon gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë si të pa bazuar dhe kërkon shpenzimet e procedurës dhe atë për dy seanca të mbajtura 270€, një seancë të shtyer 75€ , gjithsej 355€.

Në seancën e datës 06.07.2021 gjykata ka dëgjuar dëshmitarin F.D. i cili ka deklaruar se E. e ka motër, ndërsa Sh. e ka njerik, babai i tij I. është martuar me Sh. në vitin 2001 dhe të njëjtit kanë edhe një djalë A.. Nuk ka pasur njohuri që babai i tij e ka përpiluar një kontratë mbi dhuratën, vetëm dëshiron që për aq kohë sa babai të jetë gjallë i njëjti të jetojë në atë shtëpi, ndërsa pas vdekjes së tij ajo shtëpi ti takoj Sh. dhe djalit të tyre. Në vitin 2006 janë ndarë nga bashkësia martesore, babai ka pasur 9 fëmijë me nënën e tyre ndërsa tani ka një djalë me Sh., po në atë vitë kanë ndarë edhe pasurinë. Shtëpinë në të cilën jeton babai i tij me gruan Sh. e kanë blerë pas ndarjes së pasurisë familjare.

Në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar edhe vet paditësja E.D. e cila deklaron se kontrata e cila është nënshkruar tek noteri është e kundërligjshme sepse noteri ka pranuar të nënshkruaj kontratën duke e parë gjendjen e babait të saj dhe pa vërtetuar se a është i vetëdijshëm se çka po nënshkruan, prandaj kërkon që kjo kontratë të anulohet dhe të shqyrtohet edhe një herë pasuria e babait të saj, gjithashtu sa i përket ndarjes së pasurisë është ndarë vetëm në 4 pjesë kurse vajzat nuk kanë marrë asnjë pasuri nga babai.

Dëshmitari P.D. deklaron se paditësen e njeh pasi është vajza e I.D. ndërsa I.D. ka qenë i martuar me motrën e tij Sh.D. të cilët janë martuar diku rreth vitit 2001-2002 dhe në atë kohë kanë pasur dy shtëpi në Ferizaj dhe të gjithë kanë jetuar së bashku. Në vitin 2006 I. i ka shitur të dy shtëpitë dhe ato para ia ka ndarë të gjithë fëmijëve të tij, por sipas tij E. nuk i ka marrur parat por ja ka dhënë motrës së saj dhe me pjesën tjetër të parave I. e ka blerë një pronë dhe ka ndërtuar një shtëpi në të cilën kanë jetuar se bashku me Sh. dhe fëmijën e tyre. Në atë kohë I.

ka qenë në gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe është kujdesur për gruan e tij dhe vajzën e paralizuar tani më të ndjerë kurse para një viti Imeri ka filluar që të ketë probleme shëndetësore.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Fatura e tatimit në pronë në emër të I.D., Certifikata e vdekjes në emër të I.D., Kontrata LRP.nr.16505/2019, Aktvendimi C.nr.491/21 të datës 08.07.2021.

Gjykata pas provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka vlerësuar veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe në kuptim të nenit 8 të LPK, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i fakteve dhe provave të çështjes ka konstatuar se nuk është kontestuese se është lidhur kontrata e dhuratës LRP.nr.16505/2019, Aktvendimi C.nr.491/21 të datës 08.07.2021.

Nga kontrata me nr.LRP.nr.16505/2019 ref.nr.5648/2019 e datës 22.10.2019 Imer Duga në cilësinë e dhuratëdhënësit dhe Sh.D. në cilësinë e dhuratëmarrës kanë lidhur kontratë për dhuratën e paluajtshmërisë ku si objekt i kontratës ka qenë ‘ ’ dhuratëdhënësi I.D. i detyrohet dhuratëmarrëses Sh.D. që në shenjë falënderimi dhe pa kompensim t’ia bartë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërisë /parcelën me nr.kad....., Zk.Ferizaj, me sip.prej 444 m², e cila njësi është e regjistruar në emër të I.D., të cilën njësi kadastrale dhuratëdhënësi ia falë/dhuron dhuratëmarrëses Sh.D., me pas në regjistrat kadastral do të regjistrohet si pronar e vetme me pjesë të pronës prej 1/1.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarëve F.D. dhe P.D., të njëjtat i ka vlerësuar si dëshmi të sinqerta dhe reale, e sidomos ka pasur parasysh deklarata e djalit të I.D., F.D. i cili ka deklaruar se babai i tij e ka ndarë pasurinë dhe se atë shtëpi e ka blerë pasi është martuar me Shyhtren, dhe se pas vdekjes së babit shtëpia duhet ti takoj Sh. dhe djalit të saj dhe I.

Në rastin konkretë gjykata ka pasur parasysh që anulimin e kontratës e ka kërkuar trashëgimtari i dhuratëdhënësit e jo dhuratëdhënësi, andaj ka vendosur ta refuzoj kërkesëpadinë pasi paditësja nuk ka qenë në gjendje me asnjë provë të dëshmojë apo të siguron

ndonjë provë materiale me të cilën do të bindej gjykata lidhur me pretendimet e saj, e të cilat pretendime kanë qenë se e paditura nuk është kujdesur për bashkëshortin e saj (babain e paditëses), ku për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat për barrën e provave, në rastin konkret gjykata ka konsideruar se paditësja nuk kanë arritur që të provojë pretendimet e tij në raport me deklaratimet se e paditura nuk është kujdesur për bashkëshortin e saj, andaj edhe është refuzuar kërkesëpadija, e gjithë kjo duke u bazuar në nenin 319 të LPK-së, në bazë të së cilës ‘ *secila palë ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*’, si dhe nenin 322 të LPK-së në bazë të së cilës ‘ *në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra nuk mund të konstatoj me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit, do të përfundoj duke i aplikuar rregullat për barrën e provave*’

Gjykata ka pasur parasysh nenin 543 Revokimi për shkak të mosmirënjohjes së thellë 1. ‘ *Dhuratëdhënësi po ashtu mund të revokojë kontratën për shkak të mosmirënjohjes së thellë nëse pas lidhjes së sajë dhuratëmarrësi sillet me dhuratëdhënësin apo me ndonjë person të afërt të tij në atë mënyrë që sipas parimeve themelore të moralit do të ishte e padrejtë për dhuratëmarrësin të mbante atë që ka marrë me dhuratë*’, ndërsa paragrafi 2 përcakton se ‘ *Dhurata po ashtu mund të revokohet nga trashëgimtari për arsye të mënyrës së sjelljes ndaj dhuratëdhënësit* ‘, por në rastin konkret gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh pretendimet e paditëses në lidhje me këtë çështje kontestimore pas kemi të bëjmë me kontratën mbi dhuratën, e që në rastin konkret paditësja e cila ka kërkuar anulimin e kontratës është trashëgimtarja e dhuratëdhënësit, por nga provat të cilat janë administruara nuk ka pasur bazë për të vendosur ndryshe, për dallim të asaj që ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi kushtet për revokim të kontratës së dhuratës janë të përcaktuara me nenin 543 të LMD-së, e të cilat nuk janë argumentuar nga ana e paditëses.

Gjithashtu gjykata ka pasur parasysh faktin se në bazë të nenit 546 të LMD-së përcakton se ‘ *kontrata për dhurim revokohet brenda një viti kur dhuratëdhënësi ka mësuar për arsyet e revokimit*’, kontrata për dhuratën është lidhur me datë 22.10.2021 ndërsa padia para kësaj gjykate për anulimin e kontratës është ushtruar me datë 24.03.2021, do të thotë që kjo padi është ushtruar jashtë afatit të përcaktuar me ligj.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në kuptim të nenit 449 dhe nenit 452 të LPK-së, duke e obliguar paditësit që të paditurës t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 345 €, dhe atë për dy seanca të mbajtura 270€ dhe një seancë të shtyer 75€.

Nga sa u tha më lartë u vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.491/21 dt.18.10.2021

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.